



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/67

Datë: 09.03.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 95, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, dhe me Ligjin Nr. 05/L-092, të nenit 3, paragrafi 1. të Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet lista e artikujve për përdorim të përbashkët që janë objekt i procedurës qendrore të prokurimit publik, e aprovuar sipas pikës 1. Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30.04.2020, me listën e bashkëngjitur në shtojcën 1. të këtij Vendimi.
2. Pikat tjera të Vendimit të Qeverisë Nr. 06/27 të datës 30.04.2020, mbesin të pandryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Artikujt dhe Shërbimet që janë pjesë e prokurimeve të përbashkëta

Nr.	Pëshkrimi	Lloji i Kontratës
1	Furnizimi me letër për kopje	Kornizë
2	Furnizimi me material zyrtar	Kornizë
3	Furnizimi me goma për automjete	Kornizë
4	Furnizimi me vetura të udhëtarve	Kornizë
5	Furnizimi me artikuj ushqimor	Kornizë
6	Furnizimi me mobilje	Kornizë
7	Furnizimi me TI (Teknologji informative)	Marrëveshje
8	Furnizimi me pemë dhe perime	Marrëveshje
9	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	Kontratë afatgjate
10	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi- me qira	Kontratë afatgjate
11	Furnizimi me karburante	Kornizë
12	Furnizimi me mazut	Kornizë
13	Shërbime të transportit ajror	Kornizë
14	Furnizimi me ujë të pijes	Kornizë
15	Shërbimet e transportit	Kornizë
16	Shërbimet e sigurimit të auto përgjegjësisë	Kornizë